



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

V E N D I M

Nr. 107, Datë 07/08/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 38, datë 15.04.2019, e Znj. A.S., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes familjare*”¹ dhe “*gjendjes shoqërore*”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Znj. A.S. ka punuar pranë Komisarariatit të Policisë Kavajë, në detyrën specialiste pranë Sektorit të Krimit Ekonomik, Financiar në Seksionin për Krimet/Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda në Komisariatin e Policisë Kavajë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Nëpërmjet Urdhërit nr. 1320/3, datë 12.11.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Znj. A.S. është liruar nga detyra dhe është vënë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi i është refuzuar pajisja me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit, me Vendim të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

¹ Referuar çertifikatës familjare nr. 015214618, datë 25.03.2019, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile së Njësisë Bashkiake nr. 4, rezulton se ankesja ka statusin familjar “e divorcuar”.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesja pretendon se nuk është pajisur me Çertifikatën e Sigurimit të Personelit, për shkak se ka qenë nën hetim për veprën penale të korrupsionit pasiv, e cila është iniciuar nga SHÇBA, në bazë të disa letrave anonime, të depozituara kryesisht nga kolegët e saj, nën emra personash të tretë. Hetimi ndaj saj ka përfunduar me pushimin e çështjes me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Shkallës së Parë Kavajë dhe në asnjë rast, gjatë hetimit të kësaj çështjeje, nuk është gjetur asnjë element i cënimit të figurës së saj si punonjëse policie. Në shkresën nr. 17/1, datë 03.04.2019, të Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Shtetit drejtuar Komisionerit, sqarohet se hetimi i çështjes së mësipërme ka filluar, pasi ankuesja ka patur shqetësime të karakterit personal nga eprorët e saj, të cilët kanë çuar, deri në hapjen e hetimit në fjalë.

Znj. A.S. pretendon se diskriminohet për shkak të “*gjendjes familjare*” dhe “*gjendjes shoqërore*”, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi edhe në mungesë të Çertifikatës së Sigurimit të Personelit, ajo mund të ishte sistemuar në një pozicion tjetër pune, ku nuk kërkohej si kusht, pajisja me këtë certifikatë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 38, datë 15.04.2019, së Znj. A.S., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 662, datë 02.05.2019, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe për dijeni Komisarariatit të Policisë Kavajë, Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar⁴ dhe ankueses A.S., ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

- Kopje e kontratës së punës së ankueses me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Kopje e librezës së punës së ankueses;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me shkurtimin DSIK.

- Urdhërat e emërimit dhe lirimt nga detyra të Znj. A.S.;
- Informacion, nëse ndaj ankueses janë dhënë masa disiplinore gjatë periudhës, që ka punuar në institucione te ndryshme në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Vlerësime për punën e kryer nga ankuesja ndër vite;
- Kopje e Vendimit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Informacion lidhur me aktin administrativ, që parashikon shprehimisht se pozicioni i specialistit pranë Sektorit të Krimit Ekonomik, Financiar në Seksionin për Krimet/Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda në Komisaratin e Policisë Kavajë, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, përfshin kriterin e pajisjes me Çertifikatën e Sigurimit të Personelit;
- Informacion i detajuar mbi pozicione të lira pune, në të gjitha institucionet në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ku nuk kërkohet si kriter punësimi pajisja me Çertifikatën e Sigurimit të Personelit;
- Të gjitha vendimet gjyqësore, të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, që kanë lidhje me Znj. A.S.;

1. Në përgjigje të shkresës nr. 662, datë 02.05.2019, të Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 662/2, datë 15.05.2019, nëpërmjet së cilës informon se Znj. Anila Kristaq A.S. ka qenë me detyrë Specialist për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, në Seksionin për Krimet/Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, në Komisaratin e Policisë Kavajë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ky funksion organik në zbatim të Urdhërit nr. 251, datë 11.02.2019, të Ministrit të Brendshëm, *“Për funksionet organike në Ministrinë e brendshme që për shkak të detyrave, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar të prodhuar nga institucionet shtetërore ose/dhe për të përfituar në kuadrin e bashkëpunimit dy ose më shumë palësh me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare”* kërkon si kriter *“Çertifikatën e Sigurimit të Personelit”*.

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, nëpërmjet shkresës nr. 10 706, datë 18.10.2018, ka refuzuar pajisjen me *“Çertifikatë të Sigurimit të Personelit”* të Znj. A.S.. Për këtë arsye, nëpërmjet Urdhërit nr. 1320, datë 12.11.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Znj. A.S. është liruar nga detyra dhe është vënë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për t’u emëruar në një funksion që nuk kërkon *“Çertifikatën e Sigurimit të Personelit”*. Emërimi i saj në një funksion që nuk kërkon *“Çertifikatën e Sigurimit të Personelit”* ka qenë dhe do të jetë në vazhdim në vëmendjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, por deri tani nuk është bërë e mundur, për shkak të mungesës së funksioneve të lira organike, të cilat nuk e kërkojnë si kriter pajisjen me këtë çertifikatë.

Njëkohësisht, ky institucion sqaron se në dosjen e ankueses nuk administrohet kontrata e saj individuale e punës, ndërkohë që librezat e punës plotësohet nga institucioni, por administrohet vetë nga punonjësi. Informacioni për të dhënat që lidhen me plotësimin e funksioneve organike në Policinë e Shtetit, nuk mund të dërgohet, pasi në zbatim të ligjit nr.8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor” konsiderohet informacioni i klasifikuar.

Bashkëlidhur shkresës nr. 662/2, datë 15.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi urdhërat e emërimit në detyrë, masat disiplinore, vlerësimet e punës dhe CV e ankueses.

2. Në përgjigje të shkresës nr.662, datë 02.05.2019, të Komisionerit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dërgoi shkresën nr. 662/1, datë 10.05.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se me shkresën nr. 10706, datë 18.10.2018, niveli i klafisikimit “Sekret”, drejtuar Ministrisë së Brendshme, DSIK ka njoftuar Vendimin nr. 241, datë 18.10.2018 “Për refuzimin me pajisje me CSP të Znj. A.S.”. Bashkëlidhur shkresës në fjalë, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar përcolli pranë KMD-së, një kopje të vendimit të mësipërm.
3. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 12.07.2019, ora 12:00, pranë Zyrës së KMD-së. Në vijim të njoftimit të KMD-së për seancë dëgjimore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 1091, datë 10.07.2019, nëpërmjet së cilës sërisht ri-dërgon informacionin e përcjellë nëpërmjet shkresës së saj, paraardhëse nr. 662/2, datë 15.05.2019, të dërguar në adresë të KMD-së.

Në seancën dëgjimore të datës 12.07.2019, u paraqit vetëm ankuesja A.S. dhe kjo seancë u zhvillua në mungesë të përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ankuesja parashtrori edhe një herë pretendimet e saj duke theksuar faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kishte detyrim sistemimin e saj në një pozicion pune, ku nuk kërkohej si kriter “Çertifikata e Sigurimit të Personelit”. Znj. A.S. u shpreh se ajo është kryefamiljare dhe ka dy fëmijë të mitur dhe se puna për të është tepër e rëndësishme për të mbajtur familjen e saj. Informacioni i marrë gjatë seancës dëgjimore u reflektua në procesverbalin e seancës dëgjimore, të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në këtë seancë.

4. Në kushtet kur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk u përfaqësua në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 12.07.2019, për efekt të shqyrtimit të ankesës së Znj. A.S., Komisioneri dërgoi në adresë të këtij institucioni, shkresën nr. 1121, datë 16.07.2019, nëpërmjet së cilës kërkoi të disponojë informacion mbi disa çështje, si më poshtë vijojnë:

- Kopje e përshkrimit për pozicionin e punës, që Znj. A.S. ka mbajtur pranë Komisarariatit të Policisë Kavajë;
- A ka qene kriter paraprak për emërimin në këtë pozicion pune, pajisja me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit?
- Informacion mbi numrin e punonjësve të Komisarariatit të Policisë Kavajë, të cilët janë liruar nga detyra, sikurse Znj. A.S., për shkak se u është refuzuar pajisja me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit, me Vendim të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Informacion mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët janë liruar nga detyra, sikurse Znj. A.S., për shkak se u është refuzuar pajisja me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit, me Vendim të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Sa prej ish-punonjësve të sipërpërmendur janë ri-sistemuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në pozicione pune, ku nuk parashikohet kriteri i pajisjes me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit?
- Informacion nëse në ish-pozicionin e punës që Znj. A.S. mbante pranë Komisarariatit të Policisë Kavajë është kryer emërim i ri. Nëse po, a është arsimimi i tij në përputhje me pozicionin e punës, si dhe a është i pajisur me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit?
- Kopje e Urdhërit nr. 251, datë 11.02.2018, të Ministrit të Brendshëm, *“Për funksionet organike në Ministrinë e brendshme që për shkak të detyrave, mund dhe duhet të njihen me informacionin e klasifikuar të prodhuar nga institucionet shtetërore ose/dhe për të përfituar në kuadrin e bashkëpunimit dy ose më shumë palësh me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare”*.

5. Në përgjigje të shkresës nr.1121, datë 16.07.2019, të Komisionerit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi shkresën nr. 1121/1, datë 31.07.2019, nëpërmjet së cilës informon se Znj. Anila Kristaq A.S. ka qenë me detyrë specialiste për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, në Seksionin për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, në Komisariatin e Policisë Kavajë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Me Urdhërin nr. 251, datë 11.02.2019, të Ministrit të Brendshëm, ky funksion kërkon pajisjen e personelit me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit. Në shkresë theksohet fakti se edhe para miratimit të urdhërit të sipërpërmendur, ky funksion kërkonte pajisjen e punonjësve me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit.

Numri i punonjësve të policisë të liruar nga detyra, për shkak se u është refuzuar pajisja me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit nga DSKI-së, është rreth 143 të tillë. Numri i punonjësve të

policisë që janë sistemuar në pozicione pune, ku nuk parashikohet kriteri i pajisjes me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit është 81 punonjës. Në shkresë theksohet se informacione të tjera mbi të dhëna që lidhen me lirime, transferime dhe plotësimin e funksioneve organike në Policinë e Shtetit apo në strukturat e saj, nuk mund të jepet pasi në zbatim të ligjit nr. 8839, datë 22.11.2001, “Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor” konsiderohen informacion i klasifikuar.

Njëkohësisht, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit e informon Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, se pasi u mundësua krijimi i një funksioni të lirë, Znj. A.S. është emëruar në një pozicion pune, që nuk kërkon si kriter pajisjen me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit.

Referuar dokumentacionit bashkëlidhur rezulton se nëpërmjet Urdhërit nr. 1241, datë 24.07.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Znj. A.S. emërohet në detyrën specialist në Sallën e Komandimit, në Komisariatin e Policisë Kurbini, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Marrëdhëniet financiare për ankuesen fillojnë në datën 29.07.2019.

Gjithashtu edhe ankuesja A.S. u paraqit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe bëri të ditur faktin e ri-emërimit të saj në detyrën e re, ku nuk kërkohej pajisja me Çertifikatë të Sigurimit të Personelit. Në këto kushte, u konsiderua se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 38, datë 15.04.2019, e Znj. A.S., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi u arriti efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONER

**Në mungesë dhe me porosi,
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

Fusha – punesim
Shkak – gj. familjare, gj. shoqerore